

Albanian Highway Concession sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Së bashku me raportin e audituesit të pavarur

mazars

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-3
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 36

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakëve të Shoqërisë Albanian Highway Concession sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albanian Highway Concession sh.p.k (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

mazars

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars
Emin Dërraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIÇ: K32123006W



Teit Gjini
Auditues Ligjor

4 shkurt 2021

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	126,757,604	142,258,195
Aktive afatgjata jomateriale-të drejtat me konçension	7	843,076,386	781,662,726
Aktive afatgjata jomateriale	7	2,126,462	1,443,091
Totali i aktiveve afatgjata		971,960,452	925,364,012
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	8	64,096,847	54,245,760
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	1,909,089,272	1,531,761,634
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	51,965,038	51,017,006
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	358,651,800	359,179,022
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	43,963,195	98,299,658
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	27,764,823	18,614,338
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,455,530,975	2,113,117,418
Totali i aktiveve		3,427,491,427	3,038,481,430
KAPITALI			
Kapitali themeltar		380,000,000	319,768,144
Humbje të mbartura		(5,575,070)	(16,172,199)
Fitimi i ushtrimit		42,457,182	10,597,129
Totali i kapitalit	14	416,882,112	314,193,074
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	1,385,579,152	1,327,554,329
Detyrime për qera financiare	16	2,300,051	3,150,555
Totali i detyrimeve afatgjata		1,387,879,203	1,330,704,884
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	15	103,426,911	14,340,194
Llogari të pagueshme tregtare	17	213,672,089	235,307,685
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	18	1,283,464,796	1,131,990,478
Parapagimet e arkëtuara	19	3,639,291	2,641,885
Tatim mbi fitimin	29	7,220,845	606,342
Detyrime tatimore	20	2,910,872	2,571,757
Llogari të pagueshme të tjera	21	8,395,308	6,125,131
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,622,730,112	1,393,583,472
Totali i detyrimeve		3,010,609,315	2,724,288,356
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,427,491,427	3,038,481,430

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e përdorimit të rrugës	22	1,228,713,522	1,437,392,903
Kthimi i kuotës pjesë të të ardhurave Autoritetit Kontraktues	22	-	(115,750,927)
Shpërndarja e kuotës pjesë e të ardhurave të përlogaritura më parë për vlerën e investimit të kryer	22	(232,531,088)	(272,106,606)
Të ardhura të përlogaritura mbi vlerën e investimit të kryer	22	1,232,152,579	1,178,777,807
Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shoqërisë	23	7,644,973	415,964,770
Total të ardhura		2,235,979,986	2,644,277,947
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(1,878,916,149)	(2,444,825,930)
Shpenzime personeli	25	(90,795,074)	(80,489,797)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(60,473,945)	(46,726,725)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(69,083,171)	(76,541,124)
Total shpenzime		(2,099,268,339)	(2,648,583,576)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	27	6,106,685	5,122,447
Shpenzime të tjera financiare (neto)	28	(92,333,772)	13,069,047
Fitimi para tatimit		50,484,560	13,885,865
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(8,027,378)	(3,288,736)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(8,027,378)	(606,342)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	30	-	(2,682,394)
Fitimi i vitit		42,457,182	10,597,129
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		42,457,182	10,597,129

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Highway Concession sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020


	Kapitali i nënshkruar	Humbje të mbartura	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	319,768,144	(177,117,339)	160,945,140	303,595,945
Emetimi i kapitalit të nënshkruar				-
Transferim në humbje të mbartura		160,945,140	(160,945,140)	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			10,597,129	10,597,129
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	319,768,144	(16,172,199)	10,597,129	314,193,074
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	60,231,856			60,231,856
Transferim në humbje të mbartura		10,597,129	(10,597,129)	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			42,457,182	42,457,182
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	380,000,000	(5,575,070)	42,457,182	416,882,112

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Albanian Highway Concession sh.p.k me datë 4 shkurt 2020 dhe janë firmosur si më poshtë:

Spandole
Z. Spartak Tumani
Administrator
Senja




Znj. Miranda Prifti
Përgatitëse e pasqyrave financiare

Pasqyra e Flukseve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	50,484,560	13,885,865
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi dhe zhvlerësimi	60,473,945	46,726,745
Të ardhura të përlogaritura mbi vlerën e investimit të kryer	(1,232,152,579)	(1,178,777,807)
Shpërndarja e kuotës pjesë e të ardhurave të përlogaritura më parë për vlerën e investimit të kryer	232,531,088	272,106,606
Shpenzime për interesa	15,806,077	14,340,194
Tatimi mbi fitimin	(8,027,378)	(606,342)
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	(9,851,087)	(32,775,531)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	621,873,044	318,532,207
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	139,999,274	654,104,178
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	54,336,463	(69,504,380)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(74,526,593)	38,031,735
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(107,070,386)	(365,251,632)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(107,070,386)	(365,251,632)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	131,305,463	325,854,135
(Ripagim)/ të hyra nga qera financiare	(789,855)	3,150,555
Rritje kapitali	60,231,856	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	190,747,464	329,004,690
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	9,150,485	1,784,793
Mjetet monetare në fillim të periudhës	18,614,338	16,829,545
Mjetet monetare në fund të periudhës	13 27,764,823	18,614,338

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Albanian Highway Concession sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shoqiptar. Shoqëria është regjistruar në datën 27 dhjetor 2016 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NIPT L62427021G. Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Rruga "Bilal Sina", Shkalla 1, kati perdue, Njësia Nr. 3, Selltë, Tiranë. Administratori i shoqërisë deri në datën 01 korrik 2020 ishte Z. Nikola Spadavecchia. Sipas vendimit të asamblesë së Ortakëve nr. 22 datë 01.07.2020 u emërua administrator i Shoqërisë Z.Spartak Tumani.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2020 ishte 80 punonjës (2019: 77 punonjës). Numri i punonjësve i ndarë sipas kategorive është si më poshtë:

- 1 administrator
- 3 drejtorë
- 9 punonjës administrate
- 1 mjek
- 1 punonjës në Burimet Njerëzore
- 32 punonjës në ndërtim dhe terren
- 33 punonjës në shitje

Marrëveshja e Konçesionit dhe ndryshimet – terma të rëndësishëm

Shoqëria "Albanian Highway Concession" sh.p.k është një shoqëri e themeluar më datë 27.12.2016 në përmbushje të kushteve e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Konçesionit për "Ndërtimin, Përmirësimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë", nënshkruar me datë 6 Dhjetor 2016 ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si Autoriteti Kontraktor (sot, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) si dhe Bashkimit të Shoqërive "Catalyst Viva Das General Contracting & Salillari Sh.p.k & Violiap & Bee Tech & Kastrati Sh.A" si Konçesionari.

Kjo Marrëveshje është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.870, datë 14 dhjetor 2016, publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr.249 datë 27.12.2016.

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është "Ndërtimi, përmirësimi, operimi (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe mirëmbajtja e autostradës Milot-Morinë". Një marrëveshje e tillë përshkruhet zakonisht si "ndërtim-operim-transferim", një "rehabilitim-operim-transferim" ose marrëveshje konçesionare shërbimi "publike-private" (KIRFN 12, P2), kryerja e veprimtarisë financiare të këmbimeve valutore në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së kushteve të Kontratës së Konçesionit Nr.2584 Rep. datë 06.12.2016, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së kushteve të kontratës së konçesionit.

Kontrata përmbush të gjitha karakteristikat e një kontrate tipike që ka të bëjë në qëlimin e KIRFN 12: Pala e cila jep marrëveshjen e shërbimit (Autoriteti Kontraktor) është një entitet i sektorit publik, të cilës i është transferuar përgjegjësia për shërbimin – Autoriteti Kontraktor në këte marreveshje është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, një entitet i sektorit publik.

Konçesionari e administron Autostradën në përputhje me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha ligjet e tjera përkatëse, që hyjnë në fuqi herë pas here në Shqipëri të lidhura me administrimin a autostrades. Ai është përgjegjës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot – Morinë si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për arritjen dhe ruajtjen e standarteve të përcaktuara të shërbimit gjatë të gjithë periudhës së konçesionit përfshirë shumë aktivitete të lidhura me menaxhimin dhe mirëmbajtjen, vlerësimin periodik të Autostradës sipas kontratës dhe kryerjen e riparimeve kapitale. Standardet duhet të përmbushen vazhdimisht gjatë të gjithë periudhës së konçesionit ndërsa Kërkesat për kthimin duhen përmbushur në fund të Kontratës. Periudha e konçesionit fillon në Datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij ("Periudha e Konçesionit").

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Në varësi të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kushtet e saj, Periudha e Konçesionit do të jetë 30 (tridhjetë) vjet. Datën e hyrjes në fuqi është 09.09.2017.

Përgjatë 30(tridhjetë) viteve të kohëzgjatjes së konçesionit, konçesionari duhet të realizojë mirëmbajtje periodike dhe rehabilitim/zëvendësim të elementeve të Autostradës si dhe punimet për kthimin në përfundim të vlefshmërisë së kontratës. Konçesionari vjel në monedhën e ligjshme të Shqipërisë, herë pas here, ose në euro, të ardhurat nga taksa e rrugës në përputhje me Klauzolën 11 të Marrëveshjes së Konçesionit, Manualit e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes të përcaktuara në Shtojcën 5 të Marrëveshjes, ose ndryshe, siç e parashikon ligji, menjëherë pas datës së fillimit të pagimit të taksës. Konçesionari duhet t'ja kthejë Autostradën Autoritetit Kontraktor(Marrëveshja specifikon në Klauzolën 36, pika 8 e Shtojcës 5) në datën e Përfundimit të vlefshmërisë së kontratës në gjendje të kënaqshme për përdorimin në vijim, sipas kërkesave të Marrëveshjes së Konçesionit.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 Janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përkufizimi i një biznesi (Amendime në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Amendime në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)
- Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

3.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR / LEK	123.70	121.77
USD / LEK	100.84	108.64
GBP / LEK	137.93	143.00
CHF / LEK	114.46	112.3

4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivët financiarë të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivët financiarë në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësitë ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësitë ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paafësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikën e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principlit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

*(Vlerat janë në Lek)***4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****4.4 Aktive afatgjata materiale***(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostat vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Toka	Nuk amortizohet
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.5 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.6 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalese.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit me të drejtë përdorimi dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin me të drejtë përdorimi kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që priten të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesit në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6 Aktivët me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivitë të drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Norma e interesit të huamarrjes e aplikuar në detyrimet e qerasë me 1 janar 2019 ishte 5.41 % për kontratën e qerasë në euro.

4.7 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.8 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.9 Trajtimi kontabël për marreveshjen e konçesionit

Shoqëria ka aplikuar KIRFN 12 për njohjen e kontratës së konçesionit.

Shërbimet e ndërtimit ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kërkesat e SNRF 15/(SNK 11) me vlerën e tyre të drejtë. Nga ana tjetër shoqëria ka njohur një aktiv financiar pasi ajo plotëson kushtet e paragrafit 15 të KIRFN 12 sipas të cilit:

Operatori do të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare ose një aktiv financiar tjetër nga ose me urdhër të konçesiondhënësit për shërbimet e ndërtimit; konçesion dhënësi ka pak, ose nuk ka, mundësi të mos paguajë, sepse zakonisht marreveshja është e detyrueshme me ligj. Operatori ka një të drejtë të pakushtëzuar të arkëtojë mjete monetare nëse konçesion dhënësi garanton kontraktualisht t'i paguajë operatorit (a) shumën të specifikuar ose të përcaktueshme apo (b) diferencën, nëse ka, midis shumave të arkëtuara nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuar ose të përcaktueshme, madje edhe kur

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.9 Trajtimi kontabël për marreveshjen e konçesionit (vazhdim)

pagesa është në varësi të plotësimit të kërkesave nga operatori për cilësinë ose efikasitetin e specifikuar të infrastrukturës.

Në bazë të interpretimeve të BSNK, shuma e garantuar mund të paguhet nga përdoruesit e rruges apo nga autoriteti kontraktues. Metoda e pagesës konsiderohet një çështje forme pasi shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar kontraktuale për të arkëtuar para.

KIRFN 12 kërkon gjithashtu që operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licencën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Një e drejtë për t'ia faturuar shpenzimet përdoruesve të shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare, sepse shumat janë në varësi të shkallës së përdorimit të shërbimit nga publiku. Në modelet e saj të parashikimit shoqëria ka parashikuar trafikun deri në nivelin e të ardhurave të garantuara.

4.10 Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumën të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4.11 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë. Shoqëria ka njohur tatim të shtyre për humbjet e mbartura.

Trajtimi i kontrates së koncesionit

Shërbimet e ndërtimi ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kerkesat e SNK 11 me vlerën e tyre të drejtë. Vlera e drejtë është përlogaritur si shuma që shërbimi i ndërtimit do të shitej si një detyrim i pavarur i kontratës së koncesionit.

Shoqëria ka rishikuar modelin e saj financiar në bazë të rezultateve faktike deri në momentin e aprovimit të pasqyrave financiare. Për pasojë, shoqëria ka njohur një aktiv financiar deri në masën e të ardhurave të pritshme të garantuara dhe një aktiv afatgjatë jomaterial për shumën e trafikut të parashikuar mbi vlerën e garantuar. Për pasojë shoqëria ka trajtuar kontratën e koncesionit në përputhje me modelin hibrid të KIRFN 12.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Albanian Highway Concession sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale janë detajuar si më poshtë:

	Makinieri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje Informatike	Mobilje e pajisje zyre	Asete në përdorim (SNRF 16)	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2019	2,206,889	58,681,933	20,198,410	64,266,561	-	145,353,793
Shtesa	20,498,806		9,833,767	7,280,883	4,583,808	42,197,264
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	22,705,695	58,681,933	30,032,177	71,547,444	4,583,808	187,551,057
Shtesa	1,537,070		13,115,416	81,333	-	14,733,819
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	24,242,765	58,681,933	43,147,593	71,628,777	4,583,808	202,284,876
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2019	204,875	10,067,524	1,783,185	2,318,883		14,374,467
Amortizimi i vitit	2,062,139	9,722,882	5,546,715	12,975,509	611,150	30,918,395
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,267,014	19,790,406	7,329,900	15,294,392	611,150	45,292,862
Amortizimi i vitit	4,261,370	7,778,306	5,845,047	11,432,925	916,762	30,234,410
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	6,528,384	27,568,712	13,174,947	26,727,317	1,527,912	75,527,272
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	20,438,681	38,891,527	22,702,277	56,253,052	3,972,658	142,258,195
Gjendja më 31 dhjetor 2020	17,714,381	31,113,221	29,972,646	44,901,460	3,055,896	126,757,604

7. Aktive afatgjata jo-materiale

Balanca e aktiveve afatgjata jo-materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	AAJM-Të drejta me konçesion	AAJM – Të tjera	AAJM- Total
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2019	474,466,835	1,613,273	476,080,108
Shtesa	322,853,297	201,071	323,054,368
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	797,320,132	1,814,344	799,134,476
Shtesa	91,403,942	932,625	92,336,567
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	888,724,074	2,746,969	891,471,043
Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2019		220,310	220,310
Zhvlerësimi i vitit	15,657,406	150,943	15,808,349
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	15,657,406	371,253	16,028,659
Zhvlerësimi i vitit	29,990,282	249,254	30,239,536
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	45,647,688	620,507	46,268,195
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	781,662,726	1,443,091	783,105,817
Gjendja më 31 dhjetor 2020	843,076,386	2,126,462	845,202,848

Aktivët afatgjata jo materiale në lidhje me të drejtat e konçesionit janë përlogaritur në përputhje me vlerësimet e paraqitura në shënimin 5 të këtyre pasqyrave financiare.

8. Inventarë

Balanca e inventarëve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Lëndë e parë	8,340,632	16,508,839
Lëndë ndihmëse	90,120	90,120
Mallra për rishitje (OBU)	22,020,589	21,545,062
Lëndë djegëse	579,768	10,584,829
Pjesë këmbimi	23,301,303	4,488,194
Inventar i imët	2,312,435	1,028,716
Parapagime për inventar (tollona karburanti)	7,452,000	-
	64,096,847	54,245,760

9. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Autoriteti Kontraktues	1,901,785,549	1,528,749,414
Klientë të tjerë	7,303,723	3,012,219
	<u>1,909,089,272</u>	<u>1,531,761,633</u>

10. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Salillari sh.p.k	51,893,038	50,945,006
Kastrati Construction	72,000	72,000
	<u>51,965,038</u>	<u>51,017,006</u>

11. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogarive të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH e arkëtueshme	358,055,753	358,991,502
Dogana	26,342	67,439
Të tjera	569,705	120,081
	<u>358,651,800</u>	<u>359,179,022</u>

12. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Balanca e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime të tjera	1,119,759	646,730
Shpenzime të shtyra	42,843,436	97,652,928
	<u>43,963,195</u>	<u>98,299,658</u>

13. Mjete monetare në arkë dhe bankë

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Likuiditete në bankë	17,163,953	12,731,601
Likuiditete në arkë	10,600,870	5,882,737
	<u>27,764,823</u>	<u>18,614,338</u>

14. Kapitali

Numri dhe vlera nominale e kuotave të regjistruara më 31 dhjetor 2020:

	<u>31.12.2020</u>		<u>31.12.2019</u>	
	Pjesëmarrja në %	Vlera e kapitalit	Pjesëmarrja në %	Vlera e kapitalit
Salillari shpk	50%	190,000,000	50%	159,884,072
Kastrati Group sh.a	50%	190,000,000	50%	159,884,072
	<u>100%</u>	<u>380,000,000</u>	<u>100%</u>	<u>319,768,144</u>

Në datën 28 dhjetor 2020, asambleja e ortakëve aprovoi rritjen e kapitalit të shoqërisë në vlerën 380,000,000 lekë. Pjesëmarrja e ortakëve në kapital mbeti e pandryshuar.

15. Huatë afatgjata dhe afatshkurtra

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua afatgjate nga Banka Kombëtare Tregtare	1,396,779,166	1,339,470,000
Shpenzime të shtyra-komisione disbursimi huaje	(11,200,014)	(11,915,671)
	<u>1,385,579,152</u>	<u>1,327,554,329</u>

Shoqëria ka nënshkruar një kontratë huaje me Bankën Kombëtare Tregtare në datën 03 maj 2017 për një vlerë totale prej 28.5 milion euro e cila do të disbursohet në disa këste. Afati i shlyrjes së kredisë është 7 vite nga data e disbursimit të kështit. Norma vjetore e interesit është Euribor 12 muaj +3% por jo më pak se 5%.

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	87,620,834	-
Interesat e maturuar të huasë	15,806,077	14,340,194
	<u>103,426,911</u>	<u>14,340,194</u>

16. Detyrime për qira financiare

Tabela e mëposhtme paraqet maturimin e angazhimeve të qerasë operacionale në detyrimin e njohur:

Detyrimi për qeratë në pasqyrën e pozicionit financiar

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrimet afatshkurtra të qirasë financiare	900,414	839,765
Detyrimet afatgjata të qirasë financiare	2,301,051	3,150,555
	<u>3,201,465</u>	<u>3,990,320</u>

Analiza e maturiteteve të flukseve të paskontuara

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Deri në një vit	1,050,955	1,035,045
1 - 5 vite	2,452,229	3,450,150
Mbi 5 vite	-	-
	<u>3,503,184</u>	<u>4,485,195</u>

Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime amortizimi të aktiveve me të drejta në përdorim	916,762	611,150
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	199,284	155,682
Shpenzime qeraje që lidhen me qira afatshkurtra	-	-
	<u>1,116,046</u>	<u>766,832</u>

17. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme tregtare	213,672,089	235,307,685
	<u>213,672,089</u>	<u>235,307,685</u>

(Vlerat janë në Lek)

22. Të ardhura

Në kontratën e konçensionit është parashikuar që në rast se shuma e të ardhurave nga tarifa e përdorimit të rrugës, tejkalon limitin e parashikuar në kontratë, 60% e këtij tejkalimi do të kthehet autoritetit kontraktues.

Shuma e përlogaritur për vitin ushtrimor në bazë të kësaj kërkesë të kontratës është 0 Lek.

Referuar politikave kontabël të përkruara në pikën 4 të shënimeve shpjeguese, shoqëria ka përlogaritur të ardhura mbi vlerën e investimit të kryer në shumën 1,232,152,579 Lek. Kjo shumë, në përputhje me SNRF 15, përfaqëson vlerën e tregut, të investimit të kryer i cili do të shlyhet kompanisë konçesionare në vitet e ardhshme nëpërmjet tarifave që do të arkëtohen nga përdorimi i rrugës në vitet në vijim. Për këtë shumë shoqëria ka njohur një aktiv financiar sic tregohet në shënimin 9 të pasqyrave financiare. Kjo shumë e përlogaritur e të ardhurave, e cila po njihet në këtë vit ushtrimor dhe do të paguhet nëpërmjet arkëtimit në vitet në vijim të tarifave nga përdorimi i rrugës, do të zvogelojë në mënyrë proporcionale përgjatë viteve të jetës së konçensionit shumën e tarifave të arkëtuara për çdo vit. Kuota pjesë e të ardhurave të përlogaritura më parë për vlerën e investimit të kryer për vitin 2020 është (232,531,088) Lek.

Siç shprehet më lart, të ardhurat e garantuara nga trafiku janë njohur si aktive financiare. Prandaj çdo faturë e taksave së pari do të konsiderohet si një shlyerje për aktivin financiar dhe tejkalimi i trafikut të garantuar do të njihet nga Operatori si të ardhura nga taksat. Për referencën tuaj të lehtë, të ardhurat nga taksat, që rezultojnë nga tejkalimi i minimumit të caktuar nga konçensiondhënësi, paraqitet nën fletën "Tatimi i të ardhurave".

23. Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shoqërisë

Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Sherbime shtesë dhënë Autoritetit Kontraktues	-	360,755,912
Shitje mallrash	239,167	53,015,583
Të ardhura nga sigurimet	7,285,806	2,073,275
Të ardhura nga qeraja	120,000	120,000
	<u>7,644,973</u>	<u>415,964,770</u>

24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Mallra	19,588,583	155,969,320
Lëndë djegëse	20,194,491	19,407,298
Mirëmbajta rutine dhe dimërore	486,816,158	568,261,063
Energji për tunelin	26,849,981	55,579,184
Nënkontraktore	1,229,291,877	1,500,413,431
Inxhinier i pavarur	55,265,500	55,039,500
Të tjera	40,909,559	90,156,134
	<u>1,878,916,149</u>	<u>2,444,825,930</u>

Koncessionari sipas Marrëveshjes së Koncesionit do të ndërtojë vepra kapitale (Punimet kapitale sipas projektit dhe kontratës) dhe do të jetë përgjegjës për dorëzimin e këtyre punimeve brënda afateve të paracaktuara dhe me miratim nga Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu koncessionari ka shpenzuar për funksionimin dhe mirëmbajtjen rutinore të gjithë autostradës Milot-Morine, duke përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen emergjente dhe dimërore; inspektimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i të gjithë komponentëve të infrastrukturës; (për trotuare, ura dhe elementë gjeoteknike, gardrela, sinjalistike, furnizimin me energji elektrike të Tunelit të Thirrës dhe gjithë pikave të furnizimit përgjatë autostradës, mirëmbajtjen dhe mbajtjen në funksion të vazhdueshëm të sistemit të taksimit në sheshin e mbledhjes së taksave, etj).

25. Shpenzime personeli

Shpenzime personeli për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	80,419,251	71,477,981
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,375,823	9,011,916
	<u>90,795,074</u>	<u>80,489,797</u>

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, ka kryer shpenzime e pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për paga e shpërblime dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave.

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime transporti	112,997	197,340
Mirëmbajtje dhe riparime	3,371,558	231,608
Sigurime	26,279,686	17,517,378
Udhëtime e dieta	7,133,741	6,644,002
Shpenzime ligjore e konsulenca	2,391,872	12,103,799
Shpenzime marketingu	12,196,000	12,420,540
Shpenzime telefon dhe Internet	-	158,663
Komisione dhe tarifa bankare	2,653,970	2,083,935
Tatime dhe taksa	956,560	485,368
Gjoha e dëmshpërblime	2,141	32,592
Të tjera shpenzime	13,984,646	24,665,899
	<u>69,083,171</u>	<u>76,541,124</u>

Koncesionari mbulon sigurimin e detyrueshëm sipas klauzoles 34 dhe Shtojces 12, sigurim sipas kushteve të mirëpërcaktuara në këtë shtojcë.

27. Shpenzime Interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa hua	(68,464,760)	(46,993,597)
Te ardhura nga interesat KIRFN 12	74,770,729	52,271,726
Shpenzime interesi SNRF 16	(199,284)	(155,682)
	<u>6,106,685</u>	<u>5,122,447</u>

Kompania financon projektin me kapital të huazuar (hua bankare dhe likujditete të përfituara nga mbledhja e taksës). Në lidhje me *kastot e Huamarrjes*, koncesionari gjatë fazës së ndërtimit konform kontrates dhe nevojave të domosdoshme për financim ka marrë kredi për financimin e punimeve të ndërtimit.

28. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzime të tjera financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(93,574,126)	(74,814,187)
Të ardhura nga veprimtaria e këmbimit valutor	4,700	
Te ardhura nga këmbimet valutore	1,235,654	87,883,234
	<u>(92,333,772)</u>	<u>13,069,047</u>

29. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	50,484,560	13,885,865
Total shpenzime të panjohura	3,031,291	8,039,043
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	1,228,508	3,948,471
Shpenzime pritje-percjellje	936,820	1,511,366
Shpenzime interesi	-	2,505,587
Shpenzime të tjera	865,963	73,619
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	53,515,851	21,924,908
Humbje fiskale e mbartur		(17,882,628)
Tatim fitimi -15%	8,027,378	606,342
	42,457,182	13,279,523
Shpenzim tatim fitimi i shtyre	-	(2,682,394)
Fitimi neto për vitin	42,457,182	10,597,129
Humbje fiskale 2017		-
Përdorim humbje fiskale në vitin 2018	-	17,882,628
Humbje fiskale 2017 për t'u përdorur në vitin 2019	-	(17,882,628)

30. Tatimi i shtyrë

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim i shtyrë nga diferenca te përkohshme nga humbjet e mbartura	-	-	-	-
Të ardhura/(shpenzime) tatimi të shtyrë	-	-	-	(2,682,394)
Aktive/(pasive) tatimore të shtyra	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>(2,682,394)</u>

31. Palët e lidhura

Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme:		
Shoqëri të lidhura	<u>51,965,038</u>	<u>51,017,006</u>
Llogari të pagueshme:		
Shoqëri të lidhura	<u>1,283,464,796</u>	<u>1,131,990,478</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Blerje mallrash dhe/ose shërbimesh:		
Shoqëri të lidhura	<u>1,702,909,444</u>	<u>1,776,082,482</u>
Shitje mallrash dhe/ose shërbimesh:		
Shoqëri të lidhura	<u>1,658,023</u>	<u>44,610,327</u>

Shpërblimi total i menaxhimit në vlerë bruto përgjatë vitit 2020 është 7,497,173 leke.

32. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivate të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaxhimin e riskut dhe manaxhimin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare. Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuartrit të manaximit të riskut të shoqërisë.

Politikat e manaximit të riskut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Albanian Highway Concession sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lek)

32. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

31 dhjetor 2020	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
Aktive monetare						
Llogari të arkëtueshme tregtare		2,045,493	1,903,596,682	1,923,877	1,523,220	1,909,089,272
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura			51,965,038			51,965,038
Llogari të arkëtueshme të tjera			358,510,329			358,510,329
Mjetet monetare në arkë e në bankë	27,764,823					27,764,823
Total	27,764,823	2,045,493	2,314,072,049	1,923,877	1,523,220	2,347,329,462
31 dhjetor 2019	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
Aktive monetare						
Llogari të arkëtueshme tregtare	3,012,220		1,526,749,414			1,531,761,634
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		51,017,006				51,017,006
Llogari të arkëtueshme të tjera			359,179,022			359,179,022
Mjetet monetare në arkë e në bankë	18,614,338					18,614,338
Total	21,626,558	51,017,006	1,887,928,436	-	-	1,960,572,000

Albanian Highway Concession sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
 (Vizat janë në Lek)

32. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të kompanisë.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019.

31 dhjetor 2020	Më pak se					Totali
	1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	mbi 5 vite	
Aktive monetare						
Llogari të arkëtueshme tregtare	7,303,723		1,901,785,549			1,909,089,272
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura			51,955,038			51,955,038
Llogari të arkëtueshme të tjera			358,651,800			358,651,800
Mjetet monetare në arkë e në bankë	27,764,823					27,764,823
Total	35,068,546	-	2,312,402,387	-	-	2,347,470,933
Detyrime monetare						
Hua afatgjata			2,009,362	1,311,411,443	72,158,347	1,385,579,152
Qera financiare	73,192	147,375	679,918	2,299,980	-	3,200,465
Hua afatshkurtra	15,806,077		87,620,834			103,426,911
Llogari të pagueshme tregtare	21,367,209	128,203,253	42,734,418	21,367,209	-	213,672,089
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	1,283,464,796					1,283,464,796
Detyrime tatimore	2,910,872					10,131,717
Llogari të pagueshme të tjera	7,494,894					7,494,894
Total	1,331,117,040	135,571,473	133,044,532	1,335,078,632	72,158,347	3,006,970,024
Ekzpozimi	(1,296,048,494)	(135,571,473)	2,183,376,580	(1,339,097,357)	(72,158,347)	(659,499,091)
Efektivi kumulativ	(1,296,048,494)	(1,431,619,967)	751,756,612	(587,340,745)	(659,499,091)	

32. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdimi)

Albanian Highway Concession sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lek)

(b) Risku i likuiditetit (vazhdimi)	31 dhjetor 2019					Totali
	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	mbi 5 vite	
Aktive monetare						
Llogari të arkëtueshme tregtare	3,012,220		1,528,749,414			1,531,761,634
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	51,017,006					51,017,006
Llogari të arkëtueshme të tjera			359,179,022			359,179,022
Mjetet monetare	18,614,338					18,614,338
në arkë e në bankë						
Total	21,626,558	51,017,006	1,887,928,436	-	-	1,960,572,000
Detyrime monetare						
Hua afatgjata				1,151,741,209	175,813,120	1,327,554,329
Qera financiare				3,150,555		3,150,555
Hua afatshkurtra	14,340,194					14,340,194
Llogari të pagueshme tregtare	23,530,769	141,184,611	47,061,537	23,486,779		235,307,685
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura			1,131,990,478			1,131,990,478
Detyrime tatimore	2,571,757	606,342				3,178,099
Llogari të pagueshme të tjera	6,125,131					6,125,131
Total	46,567,851	141,790,953	1,179,052,015	1,178,378,543	176,813,120	2,721,646,471
Ekzpozimi	(24,941,293)	(90,773,947)	708,876,421	(1,178,378,543)	(175,813,120)	(761,074,471)
Efekti kumulativ	(24,941,293)	(115,715,240)	593,161,182	(585,217,361)	(761,030,481)	

Albanian Highway Concession sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

32. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i valutës

Ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

	Aktive monetare		Detyrime monetare	
	2020	2019	2020	2019
LEK	2,252,158,154	1,869,514,688	1,300,249,330	1,162,789,866
EUR	94,635,854	90,978,118	1,706,720,694	1,558,856,605
USD	136,285	79,194	-	-
CHF	289,584	-	-	-
GBP	410,618	-	-	-
	2,347,630,495	1,960,572,000	3,006,970,024	2,721,646,471

(d) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohen se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Në datën e raportit, instrumentat financiarë mbartës të normave të interesit paraqiten nepërmjet vlerës se huave afatgjata

33. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

34. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.